Rakorderite EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Ato duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin me elektrofuzion. Tensioni I ngjitjes të jetë 40V dhe konektorët duhet të jenë me diameter 2-4mm. Rakorderite duhet të jenë të pajisura me një tregues për ngjitjen, këto tregues duhet të jenë të vendosura afër me konektorët dhe të jenë të sigurt që të mos ketë rrjedhje të materialit ngjites. Të gjitha dimensionet e rakorderive të jenë të përshtatshme për tu salduar nga një makineri saldimi. Lënda e parë që do të përdoret për prodhimin e rakorderive EF duhet të jetë e një cilësie tepër të lartë. Produktet duhet të jenë të markuara në trup me markën CE ose ekuivalent dhe produkti duhet të jetë konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj.

Permasat dhe modelet e produkteve duhet të jenë sipas preventivit.

### ***TEE PE PN10-25***

Produkti duhet të jetë i përbërë prej polietilieni të një cilësie të lartë pasi përdorimi i saj do të jetë në linjat e ujesjellesit. PE duhet të jenë të përshtatshme për tu salduar në linjat e ujesjellesit me teknologjinë me bashkim.

Produktet duhet të jenë të markuara në trup me markën CE ose ekuivalente dhe produkti duhet të jetë konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj.

Permasat duhet të jenë sipas preventivit.

### ***Reduksion PE PN10-25***

Reduksion me material PE Reduksioni duhet të gjejë përdorim në tubacionet e ujesjellsave. Reduksionet duhet të shfaqin rezistencë të lartë dhe duhet të durojnë presione deri në 16 bar.

---

Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE ose ekuivalent dhe produkti duhet te jete konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj. Permasat duhet te jene sipas preventivit.

#### ***Reduksion PE i shkallezuar PN10-25***

Reduksioni duhet te jete I tipit te shkallezuar . Produkti duhet te jete I perbere prej materiali PE dhe duhet te shfaq rezistence te larte per presionet nga 10 bar deri ne 16 bar. Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE ose ekuivalent dhe produkti duhet te jete konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj.

Dimensionet e Reduksioneve PE te Shkallezuar duhet te jene sipas preventivit.

#### ***Stafa PE PN10-25***

Te jete I perbere nga material PE me cilesi te larte dhe te kete impakt te larte rezistence. Te parandaloj rrjedhjet e mundshme te cilat mund te shkaktohen nga diferenca e dimensioneve te tubacioneve me +5mm,-5mm. Te jete e pajisur me unaze gome e cila ka shkalle te larte izolimi ndaj rrjedhjeve te kete perputhshmeri te larte ne bashkimin e tubacioneve. Materiali perberes I fashetes nuk duhet te permbaje asnje perberje kimike apo substance te huaja te cilat ndikojne ne shijen apo aromen e ujit . Ofertuesi duhet te paraqesi per produktet fasheta PE certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin ne sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGĚ). Produkti te jete I pershtatshem per instalime siperfaqesore dhe nen tokesore te cilat duhet te shfaqin rezistence ne presione mbi 10 bar

Permasat e Fasheta PE duhet te jene sipas preventivit.

#### ***Stafa EF me shpim ne prani te ujit PN10-25***

Stafa duhet te jene te perbera prej materiali cilesor PE dhe të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Stafa PE te tipit EF duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Tensioni I ngjitjes të jetë 40V dhe konektoret duhet të jenë me diameter 2-4mm. Stafa EF duhet te kete te pajisur gjithashtu punton shpuese e cila mundeson shpimin e Stafave EF dhe tubit ku Stafa do te atashohet apo instalohet . Puntot shpuese duhet te jete e pershtatshme per ta bere te mundur shpimin e fashetes dhe tubit PE, HDPE . Duhet permendur se Fasheta EF me trapan te integruar duhet te shoqerohet dhe me veglen apo leven shoqeruese qe ben te mundur operimin e procesit te shpimit te Fashetes EF dhe tubit PE apo HDPE. Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE ose ekuivalente dhe produkti duhet te jete konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj. Dimensionet e Stafave EF me trapan te integruar duhet te jene sipas preventivit.

#### ***Stafa PE EF PN 10-25.***

Stafa duhet te jene te perbera prej materiali cilesor PE dhe të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Stafat PE te tipit EF duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Tensioni I ngjitjes të jetë 40V dhe konektoret duhet të jenë me diameter 2-4mm. Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE ose ekuivalente dhe produkti duhet te jete konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj .

Dimensionet e stafave EF duhet te jene sipas preventivit.

#### ***Staf gize***

Staf gize me fllanxe jane similare si fashetat e gizes per nga funksioni por ndryshon nga konstruksioni dhe nga pershtatshmeria ne tubin ku do te instalohet. Stafat e gizes jane te konstruktuar me rripa dhe dado e ronale ku shtrengimi apo fiksimi I fashetes ne tub te rezistoje vibrimeve dhe presionit te ujit sipas standardit ISO 2531:2000 ose ekuivalentin e saj. Aplikimi I tyre duhet te jete i pershtatshem per linjat e ujesjellsave konkretisht ne tubat qe jane te perbera prej materiali PVC, PE, HDPE. Dimensionet e stafave te gizes me rripa duhet te jene sipas preventivit.

---

### ***Fasheta Riparimi Inoksi***

Fashetat duhet te jene fleksibel dhe te kene disa shtresa inoksi te veshura me gome EPDM rezistente ne temperature -20 deri +120°C dhe jene te prodhura e te pershtatshme posacerisht per linjat e furnizimit te ujit te pijshem. Te jene te pajisura me dado, bulona dhe rondele, me te njejtin material si me siper, te cilat duhet te jene te veshura me material PTFE per te penguar ndryshkjen. Produkti duhet te jete i pershtatshem per linjat e ujesjellesit.

Dimensionet e Fashetave Riparimi Inoksi te jene sipas preventivit.

#### L=200mm

Te dhenat teknike per fasheten 58-68mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 2kg

Te dhenat teknike per fasheten 68-78mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 2kg.

Te dhenat teknike per fasheten 78-98mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 2.45kg.

Te dhenat teknike per fasheten 108-118mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 2.5kg.

Te dhenat teknike per fasheten 118-126mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 2.7kg.

Te dhenat teknike per fasheten 126-146mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 2.35kg.

Te dhenat teknike per fasheten 152-162mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 3kg.

Te dhenat teknike per fasheten 198-208mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 4.2kg.

Te dhenat teknike per fasheten 248-258mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 4.23kg.

Te dhenat teknike per fasheten 261-271mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 4.36kg.

Te dhenat teknike per fasheten 300-340mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 6kg.

Te dhenat teknike per fasheten 340-360mm: presioni 10-16bar dhe pesha max 6.2kg.

Te dhenat teknike per fasheten 390-410 mm presion 10-16 bar dhe pesha max 12 kg

#### L=500mm

Te dhenat teknike per fasheten 440-460mm: presioni 8-10 bar dhe pesha max 24.86kg.

Te dhenat teknike per fasheten 490-510mm: presioni 8-10 bar dhe pesha max 27.86kg

### ***Adaptor PN 10-25***

Materiali te jete prej polipropilen me cilesi te larte te jete rezistete ndaj temperaturave nga -20 grad C deri ne 45 grad C, e faktoreve te tjere te jashtem dhe te mos jete i perbere nga substance te cilat ndikojne ne shijen dhe aromen e ujit.

Koka e filetit te jete konike per te shmangur rrjedhjet e mundshme nga diferenca e tubacioneve +5mm,-5mm. Material anti korroziv dhe perberja e materialit te jete kundra ngjitjes se algave dhe baktereve. Ofertuesi duhet te paraqesi per produktet adaptor ,certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombetar për përdorimin ne sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGĚ ose ekuivalent) .

### ***Fllanxh Adaptor***

Fllanxha Adaptor duhet te jene te perbera prej materialit celiku dhe me veshje plastike. Sistemi i konjeksionit te fllanxhave ose sistemi I mbivendosjes se vrimave duhet te jete sipas ANSI B16.5 ose ekuivalent. Permasat duhet te jene sipas preventivit.

### ***Fllanxh Saldimi***

Fllanxhat e Saldimit duhet te jene te perbera prej materialit celik dhe te jene saldueshme. Konstruktivisht ato duhet te jene qafegjata. Sistemi i konjeksionit te fllanxhave ose sistemi I mbivendosjes se vrimave duhet te jete sipas ANSI B16.5 ose ekuivalent. Permasat duhet te jene sipas preventivit.

Pjeset lidhese dhe fllanxhat per tuba celiku do te jene ST37 sipas DIN2605, EN10253, EN1092

---

### ***Fllanxhe Spar Gize , PVC , PE PN 10- PN 16***

Fllanxha Spar perdoret ne aplikimet e tubacioneve te cilat jane te perbera prej materialesh HDPE, PE,PVC. Trupi I fllanxes duhet te jete i perbere prej materiali gize .Ne brendesi te fllanxes duhet te kete ne perberjen e saj nje unaze prej materiali EPDM..

Permasat duhet te jene sipas preventivit.

### ***Fllanxhe Rregjister PN 10-25***

Fllanxha Rregjister duhet te jete me dalje fllanxhe dhe me qafe te tipit femer per te bere te mundur atashimin apo instalimin ne tub. Trupi i fllanxes duhet te jete i perbere prej materiali gize ndersa dadot dhe bulonat duhet te jene te perbera prej materiali celik inoks. Ne buzet apo pjesen anesore te qafes se fllanxes duhet te kete nje shtrese prej materiali EPDM.

Permasat duhet te jene sipas preventivit.

### ***Xhunto Zmontimi PN 10-25***

Xhuntoja e Zmontimit per nga nga funksioni eshte i njejte me Fllanxhen Rregjister diferenca e vetme eshte ne qafa e filetuar. Qafa duhet te kete nje shtrese izolacioni prej materiali EPDM. Konstruktivisht trupi duhet te jete i perbere prej materiali gize ndersa dadot dhe bulonat duhet te jene te perbera prej materiali celik inoksi.

Permasat duhet te jene sipas preventivit.

### ***Tapa PE PN 10-25***

Tapa me material PE , limiti i forces se keputjes te se ciles per 1mm<sup>2</sup> te jete jo me pak se 23N dhe te gjeje perdorimi si ne tubot e ujit dhe ne ato te gazit, te kete rezistence nga 10-16 bar. Tapa duhet ti rezistojte temperaturave te ulta, te jete e lehte ne perdorim dhe fleksibel.

Permasat e tapave duhen te jene sipas preventivit.

### ***Bashkues PP PN 10-16***

Materiali te jete prej polipropilen me cilesi te larte te jete rezistete ndaj temperaturave nga -20 grad C deri ne 45 grad C, e faktoreve te tjere te jashtem dhe te mos jete i perbere nga substance te cilat ndikojne ne shijen dhe aromen e ujit. Koka e filetimit te jete konike per te shmangur rrjedhjet e mundshme nga diferenca e tubacioneve +5mm,-5mm. Material anti korroziv dhe perberja e materialit te jete kundra ngjitjes se algave dhe baktereve dhe te jete I pershtatshem per presione 10-16 bar.

### ***Brryla PN 10-16***

Materiali te jete prej polipropilen me cilesi te larte te jete rezistete ndaj temperaturave nga -20 grad C deri ne 45 grad C, e faktoreve te tjere te jashtem dhe te mos jete i perbere nga substance te cilat ndikojne ne shijen dhe aromen e ujit. Koka e filetimit te jete konike per te shmangur rrjedhjet e mundshme nga diferenca e tubacioneve +5mm,-5mm. Material anti korroziv dhe perberja e materialit te jete kundra ngjitjes se algave dhe baktereve dhe te jete I pershtatshem per presione 16 bar. Ofertuesi duhet te paraqesi per produktet brryla ,certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombetar për përdorimin ne sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGÜ ose ekuivalenten e saj ).

Permasat e brrylave PN 10-16 duhet te jene sipas preventivit.

### ***Brryl PE***

Brrylat duhet te jene te perbera prej materiali PE dhe te jene te pershtatshem per linjat e ujesjellesave. Brrylat duhet te shfaqin rezistence ndaj presioneve te larta PN 16 .Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE ose ekuivalent dhe produkti duhet te jete konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj.Permasat e brrylave PE duhet te jene sipas preventivit



---

### ***Saracineske me celes magnetik***

Saracineska me celes magnetik ka per funksion te bllokoje rrjedhjen e ujit ne linjen e tubacioneve te abonenteve ne rast se ata nuk paguajn detyrimet qe kane ndaj Ujesjelles –Kanalizime Tirane. Produkti duhet te jete e perbere nga saracineska dhe nga kapuci magnetik. Mekanizimi i cili kryen funksion e hapjen apo mbylljen e saracineskes duhet te jete i inkorporuar ndermjet aksit te saracineskes dhe kapucit magnetik. Operimi i saracineskes duhet te behet te funksionoj sipas parimit te fushes magnetike me ane te nje celsi . Konstruktivisht trupi saracineskes duhet te jete i perbere prej materiali bronzi dhe te jete rezistent ndaj temperaturave te jashtme nga -20 °C deri ne +45 °C dhe i afte te perballoje presione te larta deri ne 16 bar ndersa kapuci magnetik duhet te jete prej materiali ferroz qe te nderveproje me magnetin

### ***Saracineske me leve***

Saracineska duhe te jete tipit me top dhe pajisur me leve per funksionimin e saj . Trupi i saracineskes duhet te jete i perbere prej bronzi dhe rezistente ndaj temperaturave te jashtme nga -20°C deri ne + 45°C si edhe ndaj presioneve te larta deri ne 16 bar. Saracineskat duhet te respektojne apo te jene ne perputhje me standardin e ANSI B2.1 ose ekuivalent per sa i perket sistemit te konjeksionit apo sistemit te instalimit te tyre ne tubacione. Permasat duhet te jene sipas preventivit.

### ***Saracineske G me Fllanxe Ø65-Ø250 PN 16***

Saracineskat duhet te jene te tipit me gjuhez ne form pyke. Gjuheza ka formen e nje pllake fleksibel e cila mundeson rrjedhjen apo bllokimin e ujit neper tubacione. Cvendosja e gjuhezes behet me ane te nje boshti i cili eshte i pajisur me fileto me seksion trapezoidal. Komandimi boshtit behet manualisht me dore nepermjet volanit ose me mekanizem ne rastin e saracineskave te cilat jane me dimension me te madh se Ø 300. Trupi i saracineskes duhet te jete i perbere prej materiali gize ku te shfaqin rezistence ndaj temperaturave ambjentale -20°C deri ne + 45°C dhe presionit 16bar. Ne trupin e saracineskave duhet te kete te inkorporuar nga te dyja anet fllanxha te cilat konstruktivisht duhet te jene sipas standardit ANSI ose ekuivalent. Saracineskat duhet te jene te pershtatshme per linjat e ujit te pijshem per ta vertuar ofertuesi ne oferten e tij duhet te paraqesi certifikaten perkatese (psh, DVGĚ ose ekuivalentin e saj ) nga nje Institucion i Pavarur. Permasat e Saracineskave me Fllanxe PN 16 duhet te jene sipas preventivit.

### ***Saracineske G me Fllanxe PN 25-40***

Saracineskat duhet te jene te tipit me gjuhez ne form pyke. Gjuheza ka formen e nje pllake fleksibel e cila mundeson rrjedhjen apo bllokimin e ujit neper tubacione. Cvendosja e gjuhezes behet me ane te nje boshti i cili eshte i pajisur me fileto me seksion trapezoidal. Komandimi boshtit behet manualisht me dore nepermjet volanit ose me mekanizem ne rastin e saracineskave te cilat jane me dimension me te madh se Ø 300. Trupi i saracineskes duhet te jete i perbere prej materiali gize ku te shfaqin rezistence ndaj temperaturave ambjentale -20°C deri ne + 45°C dhe presionit 25-40 bar. Ne trupin e saracineskave duhet te kete te inkorporuar nga te dyja anet fllanxha te cilat konstruktivisht duhet te jene sipas standardit ANSI ose ekuivalent. Saracineskat duhet te jene te pershtatshme per linjat e ujit te pijshem per ta vertuar ofertuesi ne oferten e tij duhet te paraqesi certifikaten perkatese (psh, DVGĚ ose ekuivalentin e saj ) nga nje Institucion i Pavarur.

Permasat e Saracineskave me Fllanxe PN 25-40 duhet te jene sipas preventivit

### ***Saracineske G me Fllanxe Ø300-Ø700 PN 16***

Saracineskat duhet te jene te tipit me gjuhez ne form pyke. Gjuheza ka formen e nje pllake fleksibel e cila mundeson rrjedhjen apo bllokimin e ujit neper tubacione. Cvendosja e gjuhezes behet me ane te nje boshti i cili eshte i pajisur me fileto me seksion trapezoidal. Komandimi boshtit behet manualisht me dore nepermjet volanit ose me mekanizem ne rastin e saracineskave te cilat jane me dimension me te madh se Ø 300. Trupi i saracineskes duhet te jete i perbere prej materiali gize ku te shfaqin rezistence ndaj temperaturave ambjentale -20°C deri ne + 45°C dhe

---

presionit 16bar. Ne trupin e saracineskave duhet te kete te inkorporuar nga te dyja anet fllanxha te cilat konstruktivisht duhet te jene sipas standardit ANSI ose ekuivalent.  
Permasat e Saracineskave me Fllanxhe PN 16 duhet te jene sipas preventivit

### ***Ajerues Celiku***

Produkti duhet te jete i perbere prej material gize dhe i paisur me fllanxhe sipas standardit EN 1074-4 ose ekuivalentin e saj .Ajruesi duhet te jete i pershtatshem per presione 10-20 bar.  
Permasat duhet te jene sipas preventivit.

### ***Rakorderite Zingato***

Produktet duhet te perbehen nga material metalik xingato .Presioni qe duhet te durojne te jete 16 bar ne temperaturen nga -20°C deri ne 63 °C. Ne trupin e tyre rakorderite xingato duhet te kene te kene te markuar marken CE ose ekuivalente.  
Permasat duhet te jene sipas preventivit.

### ***Manometra***

Manometrat perdoren per matjen e presionit ne linjat e ujesjellsave. Tolerancat e montimit duhet te jene ne standardin ISO ose DIN.  
Konstruktivisht manometri duhet te jete i perbere prej materiali inoksi dhe permasa 1/2".  
Presionet duhet te jene sipas preventivit .

### ***Kaseta Metalike Individuale***

Kasetat metalike duhet te jene te konstruktuar me material llamarine dhe te kene te 1 dere . Spesori I llamarines duhet te jete 2 mm si me shkalle izolimi IP54. Kasetat metalike individuale duhet qe te kene hapsire te brendshme te mjaftueshme per te instaluar matesin me permase 1/2",3/4 sebashku me elementet e tjere te instalimit. Permasat e kapakut 600x200mm, permasat totale 650x250x130mm.

### ***Dado, Bulona, Prizhoniera***

Dado dhe bulona sipas permasave ne preventiv. Të jenë material celik i temperuar. Hapi i filetos te jete 1.5 mm . Prizhonierat te jene te perbera prej materiali celik I temperuar me gjatesi 1 metroshe dhe permasa baze sipas preventivit.

### ***Valvol Moskthimi***

Valvolat e moskthimit kane per funksion mos lejimin e rrjedhjes se ujit ne rast se mungon presioni I nevojshem. Valvolat duhet te jene te tipit me pallot. Konstruktivisht trupi I valvoles se moskthimit duhet te jete i perbere prej materiali gize sipas standardit EN 1074-3 dhe EN 12334 ose ekuivaletet e tyre. Valvolat duhet te shfaqin rezistence ndaj presionit 10-16 bar si dhe ndaj temperaturave -20°C deri ne 100°C  
.Permasat e Valvolat e Moskthimit duhet te jene sipas preventivit.

### ***Guarnicion i Armar***

Guarnicionet duhet te jete te pershtatshme te perdoren per tubat e ujesjelles kanalizime.  
Guarnicionet duhet te kene aftesi solide dhe elastike qe te perballojne sforcimet mekanike qe lindin si pasoje e procesit te shtrengimit gjate instalimit ne fllanxhat e tubacioneve apo gjate periudhes se te operimit.  
Konstruksioni i tyre duhet te jete i perberje prej materialesh gomine EPDM elastike dhe celik te bute.Permasat sipas preventivit.

### ***Depozite 5000 litroshe***

Depozita me materjal rezine rezistente ndaj kimikateve dhe agjentëve atmosferikë, të kenë teknologjinë e mos lejimit të krijimit të algave. Rezina e përdorur për prodhimin e depozitave të jetë rezistente ndaj plasaritjeve dhe me fortësi të lartë. Dëndësia e rezinës të jetë të paktën 940 kg/m<sup>3</sup> dhe të ketë rezistencë ndaj thyerjes për forca minimalisht 33MPa. Depozita të jetë

---

rezistente ndaj flakëve pra ti rezistojë temperaturave minimalisht 130°C. Kapaciteti mbajtës I depozitës të jetë minimalisht 5000L dhe të ketë gjerësi max 240cm.

### ***Bashkues Gize me thumba(Prizhioniere)***

Bashkuesi i gizes me thumba shërben për të bashkuar ose lidhur me tub PE, PVC, gize, çimento, çeliku, me fibra xhami etj ndërmjet tyre. Bashkuesi duhet të ofrojë garanci dhe siguri në bashkimin e tubave me anë të elementëve të ndryshëm shtesë që shërbejnë për mbërthimin dhe shtrëngimin e tubave. Bashkuesi duhet të ofrojë një tolerancë midis dy anëve të bashkimit të tubave prej 8 gradësh ose më të lartë. Trupi i bashkuesit dhe unazat shtrënguese duhet të jenë material gize EN-GJS-500 sipas standartit EN 1563 (ose ekuivalent). Gomina izoluese e bashkuesit duhet të jetë EPDM për përdorim uji të pishëm sipas standartit EN 681-1 (ose ekuivalent). Kapset e bashkuesit duhet të jenë material POM. Bashkuesi duhet të ketë thumba të dhëmbëzuar të cilët duhet të jenë material prej çeliku sipas DIN 1.1132 (ose ekuivalent) dhe DIN 1654 (ose ekuivalent me të), që sigurojnë një lidhje të qëndrueshme të tubit me bashkuesin. Bulonat dhe rondulet duhet të jenë material inoks A2 sipas standartit EN 10088-1(ose ekuivalent) ndërsa dado duhet të jetë material inoks A4 sipas standartit EN 10088-1(ose ekuivalent). Bashkuesi duhet të jetë i lyer ose i veshur me bojë epokside që lejohet për ujë të pijshem me trashësi lyerje minimumi 250µm sipas standartit DIN 30677 (ose ekuivalent). Bashkuesi duhet të jetë i testuar sipas standartit EN 14525 dhe EN 545 (ose ekuivalente) dhe të ketë presion pune 16 bar ose më të lartë.

### ***Paste hidraulike***

Paste filetash hidraulike te jete e pershtatshme per punime hidraulike, te jete me dendesi 0,9-0,95 g/cm<sup>3</sup> sipas standartit ASTM D1298 (ose ekuivalent), e patretshme ne uje dhe jo gerryese. Pika e ndezjes te jete me e larte se 230 C, dhe kjo te jete testuar sipas standartit ASTM D 92 (ose ekuivalent).

### ***Tub fleksibël pvc***

Tubi fleksibël duhet të jetë prej material PVC i cilësisë së lartë, i cili përdoret për furnizim me ujë, tharje e thithje dhe për transportimin e lëngjeve të ndryshme gjerësisht për përdorim civil, agrikulturë dhe ndërtim. Tubi duhet të jetë i aplikueshëm në temperaturë nga -10°C deri në 60°C, rezistent ndaj kimikateve, ndaj gërryerjes, ndaj përthyerjes dhe këputjes. Tubi fleksibël duhet të ketë një rreze përthyerje nga 70 deri në 330 mm. Tubi duhet të ketë një sipërfaqe të brendshme të lëmuar në mënyrë që të mos pengohet lëngu që transportohet.

### ***Saracineske me filter te inkorporuar.***

Saracineskat prej tunxhi duhet te punojne ne presion minimumi 30 bar dhe ne temperature -10°C deri +105°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Të dy fundet e saracineskes duhet te kene filetim femër dhe te jene konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjetër te saraqineskes duhet te jene prej tunxhi.Saracineskat duhet te jene te pajisura me filter ne trup. Filtri eshte i pajisur me rrjete (ose ndryshe site) ne menyre qe te kete mundesi te mbledhe papastertite qe mund te krijohen ne tubacion. Ne saraqineske duhet te jete e shenuar te dhenat baze si madhesia e saraqineskes, emri I kompanise prodhuese ose ndonje shenje e markes etj. Te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

### ***Saracineske me ajerues te inkorporuar.***

Saracineskat prej tunxhi duhet te punojne ne presion minimumi 25 bar dhe ne temperature -15°C deri +115°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Të dy fundet e saracineskes duhet te kene filetim femër dhe te jene konform

---

standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjetër të saraqineskes duhet të jenë prej tunxhi. Saracineskat duhet të jenë të pajisura me ajerues në trup, që të ketë mundësi të nxjerrë një sasi të vogël ajri në mënyrë që të mos ketë pengesa të ujit kur kalon në saracineske. Në saracineske duhet të jenë të shënuar të dhenat baze si madhësia e saraqineskes, emri i kompanisë prodhuese ose ndonjë shenjë e markes etj. Të jenë të certifikuar për përdorim për uji të pijshëm.

### ***Flete sharre***

Fletat e sharres ose ndryshe lamat e sharres duhet të jenë cilësore dhe kënaqësitë të lartë. Ato duhet të mund të përdoren në çelik shumë të fortë deri në minimumi 1150 N/mm<sup>2</sup> ose dhe më të fortë. Fortësia e dhembëve të sharres të jetë minimumi 65 HRC ose dhe më e lartë ndërsa fortësia e trupit të fletave të sharres duhet të jetë minimumi 49 HRC (ose dhe më e lartë). Dhembëzat e këtyre fletave të sharres duhet të jenë të vëzuar. Fletat e sharres duhet të kënaqësitë të kaluar një trajtim të dyfishtë termik në mënyrë që të reduktojnë goditjet.

### ***Tulip***

Tulip përdoren për të lidhur tubin me rakorderi me flanaxhe. Lidhjet fundore të flanaxhave të këtyre koplingjeve duhet të jenë sipas standartit EN 1092-2 dhe temperatura e punës së këtyre flanaxhve adaptoreve duhet të jetë 0°C deri në +60°C (pranohet edhe diapazon me I gjere që përfshijnë diapazonin e kerkuar). Ata duhet të jenë të veshur me pudër epokside me një trashësi minimalisht 250 µm. Presioni I punës së tyre duhet të jetë PN16 ose më e lartë. Devijimi këndor I tyre mos të jetë më shumë se 5°. Bulonat e këtyre koplingjeve me flanaxhe duhet të jenë prej materiali çelik karboni 8.8 dhe të jenë të galvanizuar në të nxehtë. Gjithashtu fundet e tyre duhet domosdoshmërisht të jenë të mbrojtur me kapak plastik.

### ***Ajrues me 3 funksione Pn 16, Pn20,***

Ajruesit lejojnë nxjerrjen e ajrit në sistemet e shpërndarjes së ujit. Trupi dhe kapaku I ajruesit duhet të jenë prej materiali gize EN-GJS-400 sipas standartit EN 1563 (ose ekuivalent). Ajruesi duhet të kryejë 3 funksione, nxjerrjen e ajrit që gjendet në tuba gjatë zbrashjes së tyre, shkarkimin e rrymave të mëdha të ajrit gjatë mbushjes së tubave dhe nxjerrjen automatike të ajrit që gjendet në tuba me ujë me presion. Ajruesi duhet të ketë valvulën e nxjerrjes së ajrit, një valvulë shkarkuese dhe një valvulë sigurie. Keto 2 të fundit duhet të jenë material bronzi ose inoksi. Ajruesi duhet të jetë me flanaxha sipas standartit EN 1092-2 (ose ekuivalent) dhe duhet të jenë të testuar sipas standarteve EN 12266 dhe EN 1074-1 & -4 ose (ekuivalente me to). Ajruesi duhet të jetë I lypur me bojë epokside brenda dhe jashtë sipas standartit DIN 30677 (ose ekuivalent). Dadot dhe bulonat e ajruesit duhet të jenë material I pandryshkshëm çelik I galvanizuar ose inoks.

### ***Filter tunxhi***

Filtri të jetë material 100% tunxhi. Presioni i punës të jetë minimumi 20 bar dhe temperatura e punës -15°C deri +110°C. Të dy fundet e filtrit duhet të kënaqësitë të filetim femër dhe të jenë konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent).

Permasat e filtrave perkatesisht sipas radhës në preventiv janë:

Filtri 1 1/4" ta ketë gjatësinë minimumi 96mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 30mm, pra minimumi 15 mm nga secili krahu. Lartësia totale të jetë minimumi 62mm.

Filtri 1" ta ketë gjatësinë minimumi 68mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 27mm, pra minimumi 13.5 mm nga secili krahu. Lartësia totale të jetë minimumi 54mm.

Filtri 3/4" ta ketë gjatësinë minimumi 61mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 24mm, pra minimumi 12 mm nga secili krahu. Lartësia totale të jetë minimumi 45mm.

Filtri 1/2" ta ketë gjatësinë minimumi 50mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 20mm, pra minimumi 10 mm nga secili krahu. Lartësia totale të jetë minimumi 35mm

---

### ***Tuba dhe rakorderi PPR***

Tubat dhe rakorderite ppr jane material polipropilen dhe kerkohen te jene te perforcuara me fibra xhami. Ato duhet te jene peshe e lehte ne menyre qe transportimi dhe instalimi i tyre te jete sa me i thjeshte. Keto tuba dhe rakorderi duhet te jene konform me standartin EN 15874-2 ose ekuivalent me te. Siperfaqja e brendshme e tyre duhet te jete e lemuar dhe jo kancerogjene apo toksike ne menyre qe te mos demtohet shendeti i konsumatorit. Keto tuba dhe rakorderi duhet te mund te perdoren ne temperatura nga 10 grade celcius deri ne 90 grade celcius. Diapazone edhe me te medha pra qe e perfshijne diapazonin e kerkuar, do te pranohen. Jetegjatesia e tyre duhet te jete e larte. Gjithashtu tubat dhe rakorderite ppr te kerkuar duhet te jene kunder gerryerjes dhe te kene izolim per zhurmat dhe temperaturen. Performanca e tyre e saldimit duhet te jete e larte. Tubat dhe rakorderite ppr duhet te jene konform me kerkesat e standartit BS6920-1 ose ekuivalent me te ne menyre qe te vertetohet se keto produkte mund te perdoren ne uje te pijshem dhe nuk shaktojne asnje ndryshim ne cilesine e ujit.

### **SHENIM I RENDESISHEM**

**Ne dokumentat e tenderit tubat dh rakorderite e lartepmendura duhet te jene te shoqeruara me certifikatat e origjinines,raportet e testeve te fabrikes,certifikatat e cilesise dhe garancise te cilat vertetojne specifikimet dhe standartet e kerkuara.(Ne zbatim te rekomandimit te APP nr 2106 date24.03.2021).**

---

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

**Afatet e lëvrimit:**

<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma</b>	<b>Destinacioni</b>	<b>Periudha e dorëzimit</b>

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënues për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënues ose nuk ka qenë i dënues nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënues me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Shënim:***Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë UKT sh.a dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

*Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar i pari janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës janë krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe deklaratën për caktimin e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë.*

---



---

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën **2,997,691 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) lekë.**

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

---

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

---

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 59,953,821 (pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njësetë e një) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ( **ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre përsiper sipas akt-marreveshjes).

### **2.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen.

**2.7.**Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa , ëeb-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK

-Emri, Adresa dhe ëeb-site i kompanise prodhuese, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

-“Emertimi i Katalogut të prodhuesit.

-Referenca në katalogje, kodi I produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr I faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut ne katalogun perkates ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

**2.8.**Për të gjitha mallrat të cilat kanë kontakt me ujin e pijshëm operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë të aprovimit për përdorimin e ujit të pijshëm DVGW, ose ekuivalente ( të vlefshme) të lëshuar nga një trup i certifikuar ndërkombëtar apo kombëtar i akredituar.

**2.9.**Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit pranë AK, do të paraqesë çertifikatën e origjinës , raportet e testeve te fabrikes,certifikatat e cilesise dhe garancise së mallrave, origjinale ose fotokopje të noterizuar të tyre, te cilat shërbejnë per te vertetuar respektimin e specifikimeve teknike , cilësine apo garancinë , që mallrat duhet të kenë , në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor.(Në zbatim te rekomandimit te APP nr 2106 date24.03.2021).

#### **Shënim:**

**1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve**

---

të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

**Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.**

**Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

--	--	--	--

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
